

URDHËR
Nr. 230, datë 5.7.2012

PËR DELEGIM KOMPETENCASH

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës, të nenit 27 të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurës Administrative të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave Zëvendësministrit të Brendshëm, z. Ferdinand Poni, të trajtimit të korrespondencës për marrjen e mendimeve nga ministritë e linjës lidhur me projektvendimet e pronave që hartohen nga Agjencia e Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave Publike, në zbatim të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar dhe të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, deri në revokimin e këtij urdhri.

2. Draftet përfundimtare të këtyre projektakteve paraqiten për shqyrtim dhe miratim në Këshillin e Ministrave nga titullari i institucionit, në bazë të kreut VI, neni 43 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 584, datë 28.8.2003 “Për miratimin e rregullores së Këshillit të Ministrave”, të ndryshuar.

3. Ngarkohet Zëvendësministri i Brendshëm për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I BRENDSHËM
Flamur Noka